

LIGJ
Nr. 114/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9877, DATË 18.2.2008 “PËR ORGANIZIMIN E
PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “a” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë

1. Paga për funksion e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Paga për funksion e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga për funksion e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta të punës, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

5. Masa e shtesës për vjetërsi shërbimi, shtesës për kushte të veçanta pune dhe shtesës për drejtimin e gjykatës llogariten mbi pagën për funksion.”.

Neni 2

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit

1. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25

vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 75 për qind të pagës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Paga për funksion e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga për funksion e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion, për kushte të veçanta të punës, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

5. Masa e shtesës për vjetërsi shërbimi, shtesës për kushte të veçanta pune dhe shtesës për drejtimin e gjykatës llogariten mbi pagën për funksion.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1.1.2014 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8104, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani